



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

VENDIM

Nr 176 datë 22/12/2008

Për autorizimin e kryetarit të Bashkisë për lidhjen e kontratës së shkëmbimit me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korce dhe negocimin për blerjen e truallit prej 200 m² të ndodhur pranë shetitore « Fan Noli »

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot në datë 22.12.2008 pasi mori në shqyrtim propozimin e paraqitur nga Keshilltaret dhe në mbështetje të nenit 32 germa e dhe nenit 8 pika II të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore" i ndryshuar.

VENDOSI

- 1- Te autorizojë Kryetarin e Bashkisë Z. Niko Peleshi të lidhë kontratën e shkëmbimit me Minsitrin e Drejtësisë, në bazë të së cilës Bashkisë Korce i kalon në pronësi truallit dhe objekti ku ushtron veprimtarinë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korce ndërsa Ministria e Drejtësisë do të bëhet pronar i truallit prej 1800 m² të ndodhur në lagjen nr. 3, Shetitore "Fan Noli" në veri të lulishtes "Mihal Grameno"
- 2- Sipërfaqja e truallit prej 1600 m² i kalon në pronësi Ministrisë së Drejtësisë, vetëm pasi nga ana e Bashkisë Korce të kene përfunduar procedurat e rregjistrimit të këtij truallit pranë Zyres Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe pasi ajo të jetë pajisur me certifikatë pronësie.
- 3- Për sipërfaqen e truallit prej 200 m² e cila është pronësi private ngarkohet egzekutivi të ngrejë një komision për të negociuar me pronarët për blerjen e këtij truallit dhe me pas transferimin e tij në pronësi të Ministrisë së Drejtësisë.
- 4- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit Urban.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Rajmonda NASE

(Signature)